

Refugee agencies help and advice



November 2008

Albanian

A jeni ju viktimë e ngacmimeve raciale?

Nëse jeni sulmuar, trembur, apo fyer për arsye të ngjyrës, racës, prejardhjes etnike, ose kombësisë,, atëherë ju jeni viktimë e ngacmimeve raciale. Ngacmimi racial është veprim i rëndë kriminal, dhe mund të jetë i formave të ndryshme, të tilla si:

- Verbale:** Vërejtje ofenduese, komente, tallje apo kërcënime;
Vënia e nofkave apo sharjet e rënda;
- Ngacmime:** Telefonata apo letra fyese e të pahijshme;
Hedhje e plehrave para shtëpisë suaj, apo në kutinë tuaj postare;
Shkaktimi i zhurmave të vazhdueshme;
- Dhunë Fizike:** Dëmtim fizik ose kërcënime për t'ju dëmtuar fizikisht;
Dëmtimi i shtëpisë apo pronës suaj, si për shëmbull duke thyer dritaret apo dyert;
- Mbishkrime Raciste:** Abuzime të shkruara ose të vizatuara.

Ngacmimi racial është i paligjshëm. Personat që kryejnë veprime të tilla ndiqen penalisht nga gjykata. Çdokush ka të drejtë të jetojë pa pasur frikën se ata, shtëpia apo prona e tyre mund të sulmohen. Autoritetet të tilla si, policia, autoritetet lokale dhe institucionet arsimore kanë për detyrë t'ju mbrojnë juve dhe familjen tuaj nga ngacmimet raciale, dhe të marrin masa kundër personave që i kryejnë këto veprime. Personat që sulmojnë të tjerët për shkak të ngjyrës, racës, prejardhjes etnike apo kombësisë, mund të dëbohen nga shtëpitë e tyre, të gjobiten apo të burgosen

Çfarë mund të bëni ju?

Nëse jeni sulmuar, atëherë duhet të kontaktoni menjëherë policinë. Ju mund të shkoni në rajonin më të afërt ose të telefononi 999 – tregojini policëve se sulmi kishte motive raciale. Nëse nuk dëshironi të raportoni vetë incidentin tek policia, atëherë ka shumë organizata të cilat mund t'ju ndihmojnë që të flisni me policinë. Ju mund të flisni me ta në fshehtësi të plotë rreth incidentit dhe ata nuk do të ndërmarrin asnjë veprim pa lejen tuaj. Këto organizata përfshijnë Shërbimin për Këshillim dhe Ndhimë (One Stop Service), Këshillin për Barazi Raciale (Racial Equality Council), Zyrën e Këshillimit Qytetar (Citizens Advice Bureau), qendrën ligjore, qendrën komunitare ose grupimin refugjat që ndodhen në zonën tuaj. Duke qenë një krim, incidente të tilla ju duhet t'i raportoni gjithashtu tek institucioni që ju ka siguruar banesën. Shoqëritë e Sigurimit të Banesave dhe organizata të tjera jo fitim prurëse që sigurojnë shtëpi për njerëz në nevojë, si edhe autoritetet lokale kanë detyrim ligjor t'ju mbrojnë nga ngacmime të tilla.

Ju duhet të mbani një ditar dhe të shënoni me saktësi datën dhe atë që ju ka ndodhur. Kjo do ju ndihmojë të kujtoni me saktësi atë që ju ndodhi dhe kur ju ndodhi, dhe nga ana tjetër do t'i tregojë ngjarjen personit që ju ndihmon për të kuptuar sesa serioz është problemi.

Fletëpalosje të tjera janë të disponueshme tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Si mund të ndihmoheni?

Autoritetet Lokale, si edhe policia duhet të ndërmarrin hapa praktikë për të ndaluar ngacmimet dhe për të mbështetur viktimat e ngacmimeve me motive raciale.. Ata mund të:

- Identifikojnë të dyshuarit si autorë të ngacmimeve dhe të ndërmarrin hapat e duhur ligjor;
- Këshillojnë pronarët e shtëpive për të rritur masat e sigursë në banesa;
- Informojnë departamentin e arsimit apo shkollën nëse një fëmijë është ngacmuar;
- T'ju drejtojnë juve te organizata të tjera të cilat ofrojnë mbështetje apo këshillime të mëtejshme.

Kontaktimi i Përkrahjes ndaj Viktimave (Victim Support)

Nëse mendoni se jeni një viktimë e krimeve apo incidenteve raciale, ju mund të kontaktoni gjithashtu Përkrahjen ndaj Viktimave, e cila është organizatë kombëtare bamirëse për viktimat e shkaktuara nga krimet. Përkrahja ndaj Viktimave ju siguron mbështetje emocionale, informacion dhe ndihmë praktike. Nëse është e nevojshme ata mund të kontaktojnë organizata të tjera në emrin tuaj, si policinë ose departamentin e sigurimit të shtëpive. Ju mund të kontaktoni Përkrahjen ndaj Viktimave duke telefonuar në numrin 0845 3030 900. Nëse nuk flisni anglisht, atëherë do t'ju sigurohet një përkthyes. Ju duhet të deklaroni gjuhën tuaj e të jepni numrin tuaj të telefonit dhe më pas një këshillues sëbashku me një përkthyes do t'ju telefonojnë mbrapsh.

Kini parasysh, secila nga organizatat e përmendura më sipër mund t'ju ofrojë këshillim. Biblioteka që ndodhet në zonën tuaj dhe numratori telefonik kanë numrat e tyre te telefonit.

Asylum Support Partnership consists of:

Migrant Helpline, charity number: 1088631 www.migranthepline.org.uk
Refugee Action, charity number: 283660 www.refugee-action.org.uk
Refugee Council, charity number: 1014576 www.refugeecouncil.org.uk
Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 www.scottishrefugeecouncil.org.uk
Welsh Refugee Council, charity number: 1102449 www.welshrefugeecouncil.org